



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 18.07.2018, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës

Diskutimi dhe miratimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela dhe Almira Xhambulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj,

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave,
Silvana Banushi – drejtore e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në MEF,
Luljeta Dauti - përgjegjëse sektori në MEF,
Tedi Bushaj – specialist në MEF,
Shpresa Shahaj - specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë e Jashtme,
Irena Dai - specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë e Jashtme.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirdita të gjithëve!

Faleminderit që jeni këtu sot, për të diskutuar lidhur me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti* s. p. a. “Për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit””.

Për të kaluar në diskutim këtë projektligj, ne kemi thirrur Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Të thirrur në këtë dëgjese, për të kaluar këtë projektligj, kemi këtu zonjën Daina Sorensen, zëvendësministre, Silvana Banushin, drejtore, Luljeta Dauti, përgjegjëse sektori dhe Tedi Bushaj, specialist.

Nga Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme është Shpresa Shahaj, si dhe Irena Dai, specialiste në drejtori. Ka ardhur zonja Shpresa? Nuk ka ardhur. Në rregull.

Do të donim nga ju, që të na jepnit një informacion të shpejtë lidhur me këtë marrëveshje. Ne e kuptojmë se është marrëveshje në kuadrin e një programi dypalësh, të ratifikuar me një ligj të veçantë, që në vitin 2017. E kuptojmë se kjo është një marrëveshje, e cila shkon në vazhden e këtij programi bashkëpunimi që kemi ratifikuar, por meqenëse i shërbejnë profesioneve që vijnë në fushën e inovacionit, do të kishim shumë nevojë të informoheshim pak, për të ditur ç’po ndodh në vendin tonë, duke pasur parasysh se arsimi profesional dhe fusha e inovacionit janë shumë të rëndësishme për tregun e punës në Shqipëri.

Ju faleminderit!

Fjala për ju, zonja Sorensen.

Daina Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për fjalën! Pa dashur ta përsëris edhe një herë, realisht në këtë rast bëhet fjalë për një marrëveshje huaje, e cila në totalin e saj është 5 milionë euro. Ju e përmendët që marrëveshja qeveritare mes dy palëve është ratifikuar në 2017-ën, ndërsa tani po merremi vetëm me ratifikimin e marrëveshjes financiare.

Kushtet financiare të kësaj huaje janë një normë interesi zero për vlerën 5 milionë, kështu që implikimet financiare janë relativisht të ulëta. Në vetvete, kjo ndërhyrje parashikon të kontribuojë drejt rezultateve dhe synimeve që ka strategjia kombëtare për punësim dhe aftësim. Janë katër prioritet kryesore dhe rezultate të pritshme, të mbuluara me këtë financim. Konkretisht

organizimi, zhvillimi dhe ngritja e qendrës multifunkzionale të Fierit, ku teorikisht po flasim për shkollën “Rakip Kryeziu”, njëkohësisht edhe shkollën mekanike të Lushnjës, të cilat do të jenë dy shkollat, dy institucionet përfituese primare nga kjo ndërhyrje.

Elementi i dytë, shumë i rëndësishëm, është zhvillimi, ngritja e kurrikulave të reja, kurrikula që flasin shumë më mirë me tregun e punës dhe u përgjigjen nevojave të sektorit privat. Një element shumë i rëndësishëm është edhe ndërtimi i marrëveshjeve të qëndrueshme dhe të përshtatura sipas kushteve, ndërmjet shkollës multifunkzionale dhe sektorit privat. Në nivel politikash do të nënvizojë sigurimin e koherencës me IPA 2 apo me atë që e njohim ndryshe si mbështetje buxhetore ndërsektoriale për sektorin e arsimit dhe të formimit profesional.

Në terma shumë të prekshëm, pavarësisht fjalës inovacion, nuk është në atë termin, në atë vizionin e inovacionit që flasim, por në rastin konkret bëhet fjalë për një shkollë bujqësore. Ndërhyrja do të jetë ekskluzivisht me profile që kanë të bëjnë me bujqësinë, por edhe parë nga këndvështrimi i mjeteve që përdoren në sektorin e bujqësisë.

Ndërhyrjet në vetvete dhe këto fonde parashikohet të përdoren në kontekstin e ngritjes së qendrës multifunkzionale. Në radhë të parë do të jetë rehabilitim i infrastrukturës, blerje mallrash, pajisje laboratorësh, konvikti, që u përkasin kësaj shkolle. Po ashtu, parashikohet asistencë teknike në lidhje me zbatimin e kësaj.

Elementi i dytë shumë i rëndësishëm, është elementi kurrikular. Në thelbin e saj, qendra multifunkzionale ka arsim të mesëm profesional, por paralelisht me të ka edhe kurse afatshkurtra, që mund t’u shërbejnë qindra fermerëve, të cilët mund të kenë nevojë për njohuri të specializuara vetëm në një fushë. Ata mund të jenë të rinj, mund të jenë adultë, dhe nuk kanë nevojë të bëjnë një program të stërgjatur, por me kurse afatshkurtër, njëmuor, dymuorë, gjashtëmuorë, sipas natyrës së kursit. Këto do të afrohen brenda asaj që ka qenë dikur një shkollë e mesme e thjeshtë.

Elementi i tretë, shumë i rëndësishëm, është postsekondari, që do të thotë se përtej arsimit të mesëm profesional, të ofrohet edhe arsim i pasmesëm, kurrikula këto, që në sistemin tonë të arsimit profesional janë totalisht të munguara.

Element shumë i rëndësishëm është edhe ai i praktikave profesionale dhe i bashkëpunimit të ngushtë me biznesin. Projekti ka një komponent relativisht të vogël në madhësinë financiare, që merret ekskluzivisht me këtë komponent.

Elementi i fundit është pilotimi dhe ndërtimi i një pakti territorial për arsimin profesional e për punësimin, i cili po ashtu ka një fond të parashikuar për të financuar ndërhyrje konkrete, të prekshme në sektorin e bujqësisë.

Me pak fjalë, kjo ishte një rezymë e shkurtër e asaj që parashikohet në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Në fakt, në këtë komision, relator për këtë projektligj kemi zgjedhur zotin Bujar Çela, i cili vjen pikërisht nga zona që ju përmendët se do të shkojë projekti dhe ajo zonë është përfituese.

Ne e kemi shënuar që në kalendar për të miratuar këtë projektligj, por na vjen mirë që kemi bërë një zgjedhje ashtu siç duhet në lidhje me relatorin e këtij projektligji.

A kemi ndonjë pyetje për përfaqësuesit e Ministrive? Po, zonja Rista.

Adelina Rista – Faktikisht, mua më vjen shumë mirë që do ta jap votën time pro kësaj marrëveshjeje, këtë e deklaroj, për arsye se shkolla “Rakip Kryeziu” është shkolla bujqësore që është një nga dy përfitueset, një e ka Bujari dhe një e kam unë. Shkolla “Rakip Kryeziu” është në zonën që unë mbuloj si deputete, është një shkollë, për të cilën mund t’ju them se është model. Fieri ka dy shkolla të mesme profesionale: shkollën “Petro Sota” dhe shkollën “Rakip Kryeziu”.

Unë dua t’ju them se në legjislaturën e kaluar kam qenë relatore pikërisht për arsimin profesional, kur është ndarë fusha e kompetencave. Për t’i rënë shkurt, më vjen mirë që arsimi profesional ka arritur këtë rezultat. Sado që mund ta përdorë politikisht krahu tjetër, ne themi se arsimi profesional ka ecur, sepse kjo është e vërteta. Shkolla “Rakip Kryeziu” çdo gjë mund të ishte, por vetëm shkollë e mesme bujqësore nuk ishte në 2013-ën, kur ne e trashëguam në atë gjendje. Ishin të gjitha degët dhe vetëm degët e profilit bujqësorë mungonin, kur ajo ka qenë një shkollë me emër në të gjithë republikën, një nga shkollat më të mira e më të vjetra bujqësore në republikë. Sot ajo është rikthyer në identitet, me degët e veterinarisë, agronomisë, agrobiznesit, teknologjisë ushqimore e të tjera, e të tjera. Ka një fluks nxënësish, ka një territor që është investuar, ka një bazë prodhuese e një bazë praktikash profesionale, ka konvikt me standarde bashkëkohore, mjedise ku vijnë njerëz nga e gjithë republika, domethënë vijnë nxënës, të cilëve u jepet bursë për degë të veçanta.

Kësisoj, unë ju ftoj ta votojmë këtë projektligj, sepse shkolla “Rakip Kryeziu” e meriton që shikimi të drejtohet nga ajo, si dhe të investohet, që të mos jetë thjesht shkollë e mesme profesionale, por edhe qendër e rëndësishme multifunksionale, e cila të ofrojë shërbim edhe për të

gjithë ata që janë në punë, që janë në mosha të mëdha dhe duan të marrin një profesion, që ushtrojnë në praktikë atë profesion, por nuk kanë një certifikatë, e cila të vërtetojë se janë të aftë në atë profesion. Pra, mund ta marrin atë certifikatë ose të ofrojnë kurset këtu. Pra, një qendër e rëndësishme multifunksionale në shërbim të të gjithë komunitetit.

Prandaj, sinqerisht, ju ftoj që ta votojmë këtë projektligj.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Rista!

Në fakt, përfaqësues të ministrisë, ne kemi pasur nevojë, herë pas here, që të bëjmë edhe një dëgjese për arsimin profesional, sepse ka shumë informacione, por ka edhe pak kakofoni.

Në fakt, gjëja që kemi vënë re gjatë këtyre viteve, së fundmi, në këto dy vite shkollore, është se numri i nxënësve që frekuentojnë arsimin profesional është rritur shumë e po ashtu është rritur edhe numri i atyre që diplomohen, të cilët kanë një shans rreth 80 % më të lartë për të gjetur punë sesa ata që mbarojnë një shkollë normale ose një shkollë të mesme të përgjithshme.

Ndërkohë, kemi vënë re se herë pas here këtu është ngritur problemi lidhur me numrin e munguar të mësuesve që japin këto degë të arsimit profesional. Për faktin që është rritur numri i shkollave, është rritur numri i nxënësve, besojmë se ka nevojë për një koherencë në informacion.

Do të kishim nevojë që, në një të ardhme të afërt, të bënim edhe një dëgjese me ju në lidhje me këtë gjë, sepse mendojmë se është e rëndësishme për publikun që të kuptojë se si po zhvillohet arsimi profesional në vend.

Gjithashtu, unë dua të shtoj edhe një informacion për kolegët. Për ta përmbledhur, nëse ju kujtohen dëgjesat që kemi bërë në llogaridhënie, sidomos në ato me ministrat e linjave përkatëse, një nga gjërat që kemi kuptuar është se programi i investimeve publike, në fakt është përkthyer i gjithi në punëzënie, se sa njerëz do të fitojnë punë nga programi i investimeve publike, gjë që lidhej ngushtësisht me arsimin profesional në sektorët bazë, si: bujqësia, turizmi dhe, natyrisht, sipërmarrja e vogël e *startup*-it. Prandaj, kemi nevojë t'ju dëgjojmë në një të ardhme të afërt në lidhje me këtë.

Tani, në qoftë se keni nevojë të bëni diskutime të tjera në parim, unë ju ftoj të më thoni. Në rast të kundërt, mendoj se duhet ta hedhim në votim në parim këtë projektligj, ta votojmë nen për nen e pastaj ta votojmë në tërësi.

Ka ndokush nevojë të bëjë ndonjë diskutim në parim?

Po, Bujar.

Bujar Çela – Përsëritës përfaqësuesit e ministrisë për shpjegimin që i bënë këtij relacioni. Një pjesë të mirë të fjalëve m'i hëngri Adelina. Si për rastësi, këto dy shkolla janë edhe në zonën e duhur, në qarkun Fier. Këto shkolla kanë pasur emër, ua kemi humbur emrin, por mendojmë se me këtë investim, që thuhet se për 120 ditë fillon pagesa e principalit, e rëndësishme është të shtohet shumëllojshmëria, sepse realisht, ekonomia jonë shkon për shtat me thënien e Kryeministrit: “Punë ka, por specialistë nuk ka”. Dhe realisht nuk ka. Shumë nga ne kemi lënë profesionin dhe i jemi kthyer edhe kuzhinierit, i jemi kthyer edhe saldatorit, edhe elektrikistit, kemi bërë edhe xhenerikun, sepse ky vakum i krijuar gjatë këtyre viteve duhet mbushur.

Kjo kredi, kjo huadhënie prej 5 milionë eurosh, shpresoj se do ta marrë vlerën e saj në periudhën kur të fillojë ai pagimi i principalit, pas dhjetë vjetësh. Do të mbjellim sot, që të korrim në atë kohë, por është diçka e domosdoshme.

Me gjithë fjalimin e gjatë që mbajti kolegja Rista para këtij komisioni, do të them se duhet të fuqizohen edhe konviktet e atyre dy shkollave, sepse zakonisht, zanatet i do industria jonë e Shqipërisë, që është bujqësia.

Ne nuk mund të kemi industri armësh, teknologji gjysmëpërçuesash apo avionësh, por industria jonë është bujqësia. Këto i shkojnë për shtat dhe i japin hov kësaj ekonomie.

Në fund, doja të thosha, gjithmonë pa i ngelur qejfi Adelinës: unë jam nxënës i shkollës së mesme “Rakip Kryeziu”.

Milva Ekonomi – A e do fjalën dikush tjetër, pas këtij diskutimi gjithë pasion?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, Ismeti.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi.)

Ismet Beqiraj – Të them të vërtetën, të flasësh pas kolegut tim Çela, është e vështirë, por unë, si deputet i qarkut të Fierit, e më shumë si përfaqësues i naftëtarëve, po xhelozohem në lidhje me pjesën e përqendrimit të vëmendjes, sepse zhvillimi i bujqësisë, i blegtorisë, i pemëtarisë, siç e konceptoj unë, nuk mund të kuptohet pa zhvillimin e mbajtjen në këmbë, edhe profesionalisht, të industrisë së naftës. Prandaj, xhelozia ime është edhe në formë kërkesë, jo lutjeje por kërkesë, që të orientojmë projekte e programe edhe në fushën e arsimit dhe formimit profesional në drejtim të teknologëve të fushës së industrisë së naftës. Është një shkollë në Fier, që është shkollë industriale, një shkollë politeknike, e cila nuk i përmbush plotësisht kërkesat dhe nevojat e industrisë së naftës. Shfrytëzoj rastin, duke mbështetur sugjerimin që bëri drejtuesja e mbledhjes

dhe nënkryetarja e komisionit, që të bëjmë një dëgjese, meqenëse edhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë e ka në varësi të plotë, në të gjitha hallkat, organizimin dhe menaxhimin e shkollave të arsimit dhe formimit profesional, duke qenë edhe në koherencë të plotë me programin e qeverisjes sonë, që në çdo bashki të ngrihet një shkollë profesionale. Unë, si deputet i Fierit, sidomos për zonën e Mallakastrës, kërkoj industrinë e përpunimit të naftës, meqenëse e kemi të instaluar aty, si dhe industrinë e nxjerrjes së naftës. Shkolla të tilla kanë mbetur në fillimet e tyre, si qëmoti, qëkurse ka filluar industria e naftës, dhe tani nuk i përmbushin nevojat dhe kërkesat që janë. Kjo bëhet emergjente edhe me implementimin e statusit të naftëtarit, kur shumë specialistë të industrisë së naftës, të nxjerrjes e të përpunimit, dalin nga këto sektorë dhe vendet mbeten vakante.

Ky do të ishte një sugjerim. Duke shfrytëzuar rastin, unë e mbështes komplet dhe për herë të parë shoh se në këtë marrëveshje, në këtë ratifikim, nuk bëhet investim vetëm në infrastrukturën e shkollës, por bëhet investim edhe në hartimin e kurrikulave dhe në trajnimin e atyre që do të bëjnë kurrikulat, që do të jenë bazë për ngritjen e arsimit dhe formimit profesional.

Ju faleminderit!

Inshallah do t'ju prekë në sedër edhe kjo kërkesa modeste që sapo bëra unë.

Milva Ekonomi – Në rregull! A do të shtosh diçka, Fadil?

Fadil Nasufi – Pa dyshim, e përshëndesim marrëveshjen e qeverisë shqiptare me *Cassa Depositi e Prestiti*. Është e dyta që kalojmë, sepse një e kaluam për infrastrukturën dhe kjo për arsimin profesional shkon në dy shkolla që kanë emër shumë të mirë që para viteve '90, kohë kur kanë qenë modele në fushën e bujqësisë e të mekanikës, si dhe në një qark që e ka prioritet bujqësinë.

Meqenëse përfaqësuesit e ministrisë janë prezentë, dua t'ju sjell në vëmendje një fakt: që prej një viti është ngritur edhe në Berat qendra e formimit profesional, me 12 ambiente, por nuk ka pajisje, bazë laboratorike, si dhe nuk e ka të miratuar strukturën. Duhet të vihet në punë. Kemi bërë edhe një memo, e kemi sjellë, edhe Kryeministri e la si detyrë në dëgjuesën publike që bëri në Berat. Kështu, përfitimet që marrim për investime në godina dhe në të gjitha programet që kanë të bëjnë me arsimin profesional, ne duhet t'i vëmë në eficiencë, duke plotësuar të gjitha nevojat me personelin përkatës e me bazën laboratorike.

Së dyti, jemi optimistë se ka shumë donatorë, siç është rasti konkret nga qeveria italiane, siç kontribuon qeveria zvicerane me *Swisscontact*, si dhe shumë të tjera, por, duke ruajtur

specifikën e çdo donatori, të mos krijojmë heterogjenitetin e pikëpamjes së menaxhimit të shkollave profesionale, sepse një veçori e kanë ato: kuadrin e personelit e kanë pa portal, pra nuk janë në sistemin e menaxhimit prej Ministrisë së Arsimit, por edhe për një menaxhim të mirëfilltë të të gjithë stafit duhet të ketë programe të unifikuara. Kjo plotëson edhe vizionin që ka qeveria, e cila në 61 bashki të ngrerë nga një shkollë, sipas specifikave që ka profili social-ekonomik i këtyre bashkive.

Ju ftoj ta miratojmë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Keni nevojë të bëni ndonjë ndërhyrje apo të bëjmë miratimin në parim?

Adelina Rista – Do të doja të shtoja diçka të fundit. E gjithë kjo që po diskutojmë është në fokusin e strategjisë apo në rrjedhën e strategjisë së qeverisë për arsimin profesional. Pra, shkon në këtë hulli: te strategjia që ka qeveria në lidhje me arsimin profesional.

Në këtë moment, Fieri është ndër katër të parët, ku po ngrihen qendra multifunksionale dhe ku i jepet mundësi çdo të riu apo të rrituri, për të marrë gjithçka që i mungon. Ky është qëllimi, dhe çdo kërkesë që vjen nga tregu i punës do ta gjejë veten përsëri këtu.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Mbas këtyre diskutimeve, që kishin edhe optimizëm të madh, kush është dakord për këtë marrëveshje në parim? Kundër? Asnjë kundër.

Miratohet!

Kalojmë në votimin nën për nën për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe *Cassa Depositi e Prestiti s. p. a.* “Për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit””.

Kush është dakord për nenin 1? Kundër? Asnjë kundër.

Miratohet!

Kush është dakord për nenin 2? Kundër? Asnjë kundër.

Miratohet!

Të kalojmë tani në votimin në tërësi të këtij projektligji për “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti s. p. a.* “Për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit””.

Kush është dakord për ta votuar në tërësi këtë projektligj? Dakord. Ka kundër? Asnjë.

Miratohet!

Ju faleminderit shumë! Në seancën e së hënës do të marrim përsipër të bëjmë disa diskutime lidhur me dobishmërinë e këtij projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ta përmbledhur, ramë dakord në parim me këtë marrëveshje, ramë dakord nen për nen dhe në tërësi. E votuam këtë marrëveshje, që ishte depozituar në komision nëpërmjet një projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shokë të dashur,

Ne kaluam sot dy projektligje. Kaluam projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

Të zgjedhur nga grupi ynë janë 2 relatorë, Adelina Rista dhe Bujar Çela.

Kini parasysh, se po përgatiten relacionet, të cilat do të depozitohen në Kuvend. Adelina dhe Bujari duhet të jenë në gatishmëri nesër, që të firmosin relacionet, që t’i depozitojmë. Dakord?

Nesër përveç seancës, kemi si detyrë të përgatitim edhe relacionet.

Pasnesër, të premtën, kemi në kalendar një dëgjese për arsimin profesional. Ndërkohë, në lidhje me arsimin profesional ka kërkesa që vijnë si nga grupi parlamentar i LSI-së, si nga grupi parlamentar i PD-së, ashtu edhe nga grupi ynë. Unë dhe Fideli bëme një kërkesë që dëgjesat për arsimin profesional t’i lëmë për në fillim të shtatorit, sepse të premtën e kemi praktikisht javën e fundit të punës.

Ndërkohë, Albana ra dakord për t’i shtyrë për në shtator, sepse po nuk ra dakord kryesia e komisionit, ne nuk marrim dot vendime. Duhet të marrim vendim të tre së bashku. Ajo ra dakord që të mund të ketë një shtyrje për në shtator. Ajo do të kthejë përgjigje brenda ditës së nesërme

për këtë gjë. Nëse do të bihet dakord në do të bëjmë dëgjese apo nuk do të bëjmë, do t'ju vijë mesazhi nëpërmjet *e-mail*-it.

Arianën duhet ta falënderojmë për punën e mirë që ka bërë, si sekretare e komisionit tonë, sepse gjithmonë na e ka dërguar të gjithë dokumentacionin.

Në mënyrë të veçantë, duhet të falënderojmë Prof. Dr. Muhamet Belën, i cili ka qenë i gatshëm për të dhënë çdo këshillë që i është kërkuar, për çështje që lidhen me arsimin, me trashëgiminë!

Të më falë, që nuk e përmenda që në fillim me titull, por desha t'i jepja një ton miqësie. Ai ka qenë vazhdimisht i gatshëm për të dhënë këshilla në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të arsimit.

Dua të falënderoj edhe Gazmend Bicin, i cili ka qenë gjithmonë i gatshëm për të na rekomanduar për çështje që kanë të bëjnë me detyrimet legislative që rrjedhin nga Rregulloja!

Për dijeninë tuaj, i kam kërkuar Gazit të na bëjë një interpretim të Rregullores, lidhur me vendosjen në rend të ditës të rasteve për të bërë mbledhje, kur këtë e kërkon 1/3 ose 1/4 e komisionit dhe për mënyrën se si hyjnë ato në kalendarin e veprimtarisë së komisionit. Shumë shpejt ky interpretim ka për t'ju ardhur me *e-mail*. Nuk ju duhet për tani, sepse praktikisht jemi në mbarim të këtij sesi legjislativ, por do t'ju duhet për një të ardhme të afërt.

Domethënë, po presim të kemi një konfirmim nga Albana nëse do të bëhet dëgjese e ditës së premte. Nëse do të bëhet dëgjese...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të shikojmë listën, si përherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, ...

Fidel Ylli - Në shtator, kur të thërrasim ministren e Arsimit për fillimin e vitit shkollor, të thërrasim edhe ministrin përgjegjës për arsimin profesional, që të na raportojë se si është situata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka se çfarë të dëgjojmë.

Milva Ekonomi – Nuk kërkuam marrëveshjen për arsimin profesional, sepse ramë dakord që, nëse do ta realizojmë ditën e premte kur është edhe fundi i ciklit mësimor, mundet. Në rast

të kundërt, do të shtyhet për në shtator. Kështu do t'ju lutesha shumë që nesër, në fund të ditës, të kontrolloni *inbox*-et e *e-maile*-ve tuaja! Pastaj do të vendosim.

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu, unë mendoj që rastin e ditës së premte t'ia lëmë në dorë Arianës, e cila vazhdimisht na ka koordinuar, na ka dërguar *e-mail*-e dhe na ka shkruar në grupin *WhatsApp*.

Kështu, falënderimi i parë dhe i fundit mbyllet me Arianën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit shumë!

Mirupafshim nesër!

MBYLLET MBLEDHJA

